



Në mbështetje të nenit 12,14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008 , nenit 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe aktit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Urdhër Obligimit për Pagesë Nr.kuponi i shpenzimit 2023-97090 datë 08.05.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.10.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

**PËR ANULIMIN E VENDIMIT 15Nr.463-4331 I DATËS 19.01.2021 PËR
PEZULLIMIIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS
KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA
NË FSHATIN RUBOFC 15NR.463-14826 I DATËS 04.03.2019**

I. ANULOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës 15Nr.463-4331 i datës 19.01.2021 e pezullimit të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për Varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019 dhe MBETET në fuqi Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për Varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.

II. Anulimi i Vendimi i Kuvendit të Komunës 15Nr.463-4331 i datës 19.01.2021, bëhet pasi që kanë përfunduar procedurat gjyqësore të inicuar nga pala paditëse dhe i njëjti është komensuar sipas aktit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Urdhër Obligimit për Pagesë Nr.kuponi i shpenzimit 2023-97090 datë 08.05.2023, përkitazi me pronën komunale të dhënë në shfrytëzim sipas Vendimit të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektorit Pronësor Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

IV. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

Nr. 15-462/01-61650

Lipjan, më 30.10.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

